



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Elbasan, më _____.____.2024

Procesverbal -Tipi i kontrates - Shërbim

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të kamerave të qytetit, të shkollave dhe fibrës optike”

LLOJI PROCEDURËS- “Procedurë e hapur–shërbim”- Marreveshje kuader

VLERA TOTALE E FONDIT LIMIT - 15.360.000 (pesëmbëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë) **lekë (pa tvsh)**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 98341110-9 - Shërbime mirëmbajtjeje

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 9.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 te miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kriteret (a-b) jane vendosur ne perputhje me Dokumentat e Tenderit te miratuara nga APP bazuar ne Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar ne Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik” i ndryshuar.

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 9;

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2.1 Kopje te deklaratave te xhiros vjetore te leshuara nga administrata tatimore pergjate tre viteve te fundit, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit te prokuruar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqese një vërtetim që ka paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2024 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri **2.2.1** është përcaktuar duke u bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe referuar nënitet 42 pika 3, 43 pika 2/b dhe nënitet 47 VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar si dhe bazuar nënitet 77 pika 3, e LPP nr.162, date 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik"; i ndryshuar

Kriteri **2.2.2** është vendosur referuar nënitet 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar si dhe bazuar nënitet 77 pika 3, e LPP nr.162, date 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar si dhe Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

Kriteri **2.2.3** është vendosur bazuar nënitet 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **40%** e vlerës së perlloritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të shërbimeve të furnizuara,

ose

- b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

Kriteri **2.3.1** është vendosur referuar nenit 41 pika 3 dhe 42 pika 3 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, (të përkthyer në shqip dhe të noterizuara) të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë.

- SSH/EN ISO 9001-2015 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalente
- SSH/EN ISO/IEC 27001:2017 "Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit" ose ekuivalente

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat ISO sipas zërave të

punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Per Prokurimin Publik", në të cilën gjejmë të percaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesi nga kompanite prodhuese/distributor të autorizuar nga prodhuesi të kamerave një autorizim (MAF) për të ofruar suport gjatë gjithë periudhës së mirembajtjes.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të percaktojë periudhën e vlefshmerisë së tij.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 6 i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që gëzojnë autoritetin e duhur të deleguar nga prodhuesi/ distributor të autorizuar nga prodhuesi të kamerave për të shërbyer në pajisjet që do të mirëmbajnë. Suporti konsiston në riparimin, zëvendësimin e pjesëve apo paisjeve të sistemeve apo çdo shërbim tjetër i cili mund të jetë i nevojshëm gjatë zbatimit të kontratës. Kjo minimizon riskun për mos respektimin e kushteve të kërkuara mbi kohën dhe cilësinë e shërbimeve që do të ofrohen.*

2.3.4 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin e kontratës, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar për 3 (tre) muajt e fundit, të paktën 7 (shtatë) persona të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kriteri 2.3.4 bazohet në Nenin 41 pika 4, germa b) dhe c) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe është vendosur duke pasur parasysh stafin dhe punonjësit e kualifikuar që duhen për realizimin e shërbimit të mirembajtjes.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar, si mëposhtë:

- Minimumi 1 (nje) inxhinier elektronik
- Minimumi 1 (nje) inxhinier telekomunikacioni
- Minimumi 1 (nje) inxhinier elektrik
- Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i sistemit të kamerave dhe të pajisur me certifikata të sigurimit teknik;

-Për inxhinieret e mësipërm duhet të paraqitet:

- kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit,
- Diploma

-Për punonjësit e mësipërm të kualifikuar duhet të paraqitet:

- kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit,
- Çertifikatat/diplomat/deshmia të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.SH”, i ndryshuar.

Shënim: Një punonjës mund të zotëroj me shume se 1 kualifikim.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi 2.3.5: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/1 gërma c), neni 77 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 41 pika 4, gërma (b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Referuar objektit të prokurimit dhe termave të referencës të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë kërkuar specialistë të nevojshëm për realizimin e shërbimeve të mirembajtjes.

Disponimi i stafit teknik të kërkuar krijon bindje tek Autoritetin Kontraktor se OE ofertues ka kapacitetet profesionale për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa për të patur 1(nje) inxhinier të profilit elektrik, lidhet me faktin se shërbimet e mirembajtjes së sistemeve dhe fibres optike kryehen në pika që kanë prani tensioni dhe pajisjesh elektrike ndaj është e nevojshme të garantohet siguria në punë dhe lidhjet sipas rregullave.

Kërkesa për të patur 1 (nje) inxhinier elektronik - Ky kriter është i nevojshëm pasi inxhinieri elektronik është personi që do të angazhohet drejtpërdrejtë në suportin e stafit të AK për problematikat që zgjidhen në mënyrë “remote” dhe nuk kanë nevojë për prezencë on-site. Gjithashtu do të suportojë grupet e teknikeve në rast problematikash komplekse gjatë procesit të mirembajtjes.

Kërkesa për të patur 1 (nje) inxhinier Telekomunikacioni - Ky kriter është i nevojshëm pasi do të jetë personi përgjegjës për monitorimin e shërbimeve të mirembajtjes sa i përket problematikave të fibres optike.

Kërkesa për të patur 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i sistemit të kamerave dhe të pajisur me certifikata të sigurimit Teknik. Certifikata nga prodhuesi i sistemit të kamerave kerkohet për garantuar se punonjesi është i aftë të kryejë shërbimin e kërkuar për pajisjet të cilat ai do të kryejë mirembajtjen.

Çertifikata e sigurimit Teknik kerkohet për të garantuar sigurinë gjatë procesit të punës.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të lëshojë deklaratë nëpërmjet të cilës merr përsipër që do të përgjigjet autoritetit kontraktor 24/7 për çdo defekt si dhe do të realizojë brenda një afatit të arsyeshëm montimin, instalimin, konfigurimin, testimin, ngjitjen e fiber optike të rrjetit apo çdo defekt tjetër që është pjesë e shërbimit të mirëmbajtjes.

Argumentimi: Kriteri 2.3.6 bazohet ne Nenin 41 pika 6, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesa e mesiperme i shërben AK si garanci se operatori ekonomik fitues do te marre persiper realizimin me sukses te sherbimit objekt prokurimi.

2.3.7 Operatori Ekonomik që do të realizojë shërbimin duhet të disponojë të paktën 2 (dy) automjete për realizimin e shërbimeve shoqëruar me dokumentacionin sa me poshtë:

Në rastin e automjetit në pronësi dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (të vlefshme), të shoqëruara me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është përcaktuar bazuar ne nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 41 pika 4/ç të VKM nr.285 ,datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor kërkon mjetet dhe pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion. Jane kerkuar dy automjete per shkak te shtrirjes se sherbimit ne gjithe territorin e Bashkise Elbasan, qytet dhe njesite administrative.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurimet. Specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, i ndryshuar si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; i ndryshuar.

NJESIA E PROKURIMIT